

Faza e parë  
Debate publike për procesin e hartimit të Kushtetutës së Kosovës

**Vendi: Skenderaj (5 shkurt, 2008) / Kuvendi Komunal**

**Panelistët: Fatmir Fehmiu, Kadri Kryeziu,**

Fjala e panelistëve: (Përmbledhje e shkurtë e diskutimit)

**Fatmir Fehmiu:** (Anëtar i Komisionit Kushtetues)

Komisioni kushtetues i përbërë nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve nacionale dhe etnike, të partive politike, të shoqërisë civile, të ekspertëve vendorë dhe të ndihmuar edhe nga ata ndërkombëtar, duke respektuar parimet e metodologjisë shkencore të hartimit të akteve juridike në përgjithësi e atë të kushtetutës në veçanti, në parimet bashkëkohore se demokracia bëhet me qytetarë e popull, ka hartuar planin e punës dhe parashikuar pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e hartimit të aktit themelor – Kushtetutën. Plani i punës përmban idenë dhe konceptin, artikulin e idesë dhe pozitivizmin e saj. E bëjmë këtë diskutim publik për të përsosur sa më mirë dhe artikuluar këtë dokument të rëndësishëm, përfshirjen e mendimeve gjatë debateve publike dhe inkorporimin e tyre në dokumentin e kushtetutës.

Është e njohur se ideja për hartimin e kushtetutës së Kosovës është e kamotshme, mirëpo procesi i realizimit të saj karakterizohet me rrugëtime specifike të cilat i diktojnë rrethanat aktuale ndërkombëtare e vendore. Andaj është dashur që për realizimin e idesë të formohet grupi strategjik politik, grupi i unitetit dhe ai negociator si një tërësi, dhe të formohen grupet punuese përkatësisht komisioni kushtetues për hartimin e materialeve të nevojshme.

Artikuli konkret i idesë ka filluar të bëhet nga grupet profesionale të ndihmuar nga ekspertë të huaj prej janarit të vitit 2007.

Projekti që gjendet në fazën e punës përfundimtare përmban: preambulën, dispozitat themelore, të drejtat dhe liritë themelore, të drejtat e komuniteteve, organet e Kosovës, Kuvendi, Presidenti, Qeveria, sistemin gjyqësor e prokurorial, Gjykatën Kushtetuese, marrëdhëniet ekonomike, qeverisjen lokale dhe organizimin territorial, institucionet e pavarura Avokati i Popullit, Revizori i përgjithshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Banka Qendrore, Komisioni i Pavarur i Mediave, dhe agjencitë e pavarura tjera.

Për të siguruar një proces demokratik dhe të hapur për hartimin e kushtetutës, komisioni i kushtetutës i ka përfshirë në planin e punë edhe përgatitjen e qytetarëve për të kontribuar me pjesëmarrjen e tyre në diskutim. Së këndejmi debati i sotëm ka për qëllim që të rrah shtigjet për inkuadrimitin e të gjithë qytetarëve pa dallim përkatësie politike, nacionale, fetare në procesin demokratik të hartimit e kushtetutës së Kosovës.

**Kadri Kryeziu:** (Anëtar i Komisionit Kushtetues)

Komisioni Kushtetues ka 21 anëtarë, prej tyre 15 shqiptarë dhe 6 minoritete. Në komision janë përfshirë ekspertë nga partitë politike, nga shoqëria civile, si dhe ekspertë nga jashtë, (Evropa, SHBA), dhe bazë për krijimin e kësaj kushtetute është marrë vullneti i popullit të Kosovës. Është bërë ndarja e pushtetit shtetëror në: legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Kushtetuta e Kosovës është ndërtuar duke i krahasuar kushtetutat e vendeve të cilat i kanë kaluar këto faza, por kanë edhe elemente të kushtetutave të zhvilluara siç është Kushtetuta e SHBA-ve. U jemi shumë mirënjohës të gjithë anëtarëve të komisionit, si dhe ndërkombëtarëve, të cilët na kanë ndihmuar që ta bëjmë kushtetutën ashtu siç

dëshirojmë ne. Në këtë kontest mund të themi se sistemi i qeverisjes parlamentare ku nënkupton se parlamenti zgjedh presidentin dhe qeverinë. Sistemi parlamentar i jep kompetenca presidentit i cili do të jetë komandat suprem i forcave të armatosura. Do të jetë njeri i cili do të vendos për akreditime të ambasadave. Nga aspekti teknik ose dizajnimi kushtetuta është gati. Në aspektin procedural kushtetuta ende nuk është gati, sepse duhet të shprehen mendimet e të gjithë qytetarëve, dhe ato do të procedohen në kushtetutë. Në kushtetutë parashihen të gjitha elementet e një shteti, të gjitha elementet që duhet t'i ketë një shtet, flamuri, stema dhe himni, ushtria, policia, shërbimi inteligjent, mbrojtja ajrore. Mund t'iu them se kushtetuta ka 150 nene dhe 14 kapituj.

### Pyetjet / komentet e qytetarëve

**Qytetari:** A do të zbatohet e drejta zakonore, a do të zbatohen edhe të drejtat e shqiptarëve, dhe a do ta përfaqësojë popullatën shumicë kjo kushtetutë?

**Kadri Kryeziu:** Pakica do të respektohet. Në historinë e re të Kosovës, për herë të parë të mbështetet shteti i Kosovës nga tërë Evropa dhe një pjesë e madhe e botës. Pra kundërshtarë e kemi vetëm Serbinë dhe Rusinë. Kjo është një e arritur e madhe, andaj edhe kjo kushtetutë është bërë së bashku me njerëzit të cilët e duan të mirën e Kosovës dhe shqiptarëve. Unë jam i bindur se kushtetuta do t'iu mbrojë interesat e shumicës, po ashtu edhe të pakicës. Ne kemi ardhur që t'iu japim informacion, sepse kushtetuta përfaqëson vullnetin e popullit shumicë të Kosovës.

**Fatmir Fehmiu:** Ato të drejta për komunitetin pakicë janë një artikulum i konventave evropiane, sikurse edhe te qeverisja lokale, edhe te organizimi territorial. Nëse duam të jenë pjesë e Unionit Evropian. Ekzistojnë dy sisteme: ai anglo-sanksion dhe sistemi kontinental që përfshinë edhe Evropën. Kur ta shikojmë të gjithë këtë duhet të jemi në binarë të asaj që quhet botë e civilizuar, humane me të drejta dhe barazi pa dallim feje, race, etj.

**Qytetar:** A e keni marrë për bazë që presidenti të zgjedhet sipas preferencave të politikanëve apo nga populli?

**Kadri Kryeziu:** Sa i përket presidentit, është menduar që ai të zgjidhet nga parlamenti, por për president mund të kandidojë secili qytetar i cili duhet të mbledhë nënshkrimet e deputetëve.

**Qytetari:** A parashihet në kushtetutë që kryetarin e shtetit ta zgjedh populli?

**Kadri Kryeziu:** Nëse vendos populli që kryetarin me zgjedh populli ne do ta dizajnojmë që kryetarin me zgjedh populli. Por ne kemi menduar si ekspertë që për momentin duhet ta zgjedh parlamenti.

**Qytetari:** A do ta kemi të gatshme në ditën e pavarësisë - Kushtetutën e Kosovës?

**Kadri Kryeziu:** Kushtetuta e Kosovës nuk do ta pengojë pavarësinë e Kosovës, do të jetë një deklaratë për pavarësinë e Kosovës e cila do të aprovohet ne Parlament.

**Qytetari:** A ka diçka që juve ju mban peng edhe pse jeni anëtarë të komisionit, siç është Dokumenti i Ahtisarit?

**Kadri Kryeziu:** Unë i përmenda tri gjëra: të gjithë ne kemi pasur dëshirë ta respektojmë vullnetin e popullit, e përmenda Pakon e Ahtisarit dhe të drejtat e minoriteteve. Nuk ka ndodhur vetëm me kushtetutën e Kosovës, por edhe me disa kushtetuta të tjera. Situata dhe realiteti është i tillë. Kur në një moment të përkrah gjithë spektri i botës demokratike, atëherë duhet pranuar edhe kompromisin, të lëshohet pe, për hir të pavarësisë dhe shtetit.

**Qytetari:** Do të ishte mirë që familja Jashari të rregullohet me status me të cilin shumë shqiptarë janë të lidhur emocionalisht dhe shpirtërisht. Të mos largohemi shumë nga vlerat.

**Kadri Kryeziu:** Sa i përket familjes së heroit legjendar, do të mundohemi që këtë ta fusim në preambulën e kushtetutës e cila është pjesë parahyrëse dhe e cila parasheh peripecitë, vuajtjet, luftën çlirimtare të Kosovës, të gjitha ato gjëra kolektive që i kanë ndodhur popullit shqiptar. Do të mundohemi që në preambulë të vendoset kjo. Ne jemi vetëm kreator të kushtetutës në kuptimin teknik. Besoj edhe sugjerimet e juaja që keni dhënë këtu, do t'i inkorporojmë në kushtetutën e Kosovës, në mënyrë që ta bëjmë një kushtetutë të kompletuar.

**Qytetari:** Si do të festohet dita e pavarësisë?

**Kadri Kryeziu:** Ne jemi popull i kulturuar dhe institucionet shtetërore do të organizohen ashtu si duhet me ushtri, polici, nuk është mirë me gjuajt shumë.

**Qytetari:** Propozoj që në kryeqendrën e Prishtinës të hedhen 7 topa, kurse te varri i komandantit legjendar të Kosovës, Adem Jashari, të hedhen 20 topa për çdo anëtar të familjes.

**Fatmir Fehmiu:** Ky kremtim duhet të jetë i dinjitetshëm. Le të jetë një organizim i mirë.

**Qytetari:** A hyjnë në Kushtetutë familjet e dëshmorëve?

**Kadri Kryeziu:** Çështja e dëshmorëve të kombit dhe çështja e luftëtarëve, do të rregullohet me ligj të bazuar në Kushtetutën e Kosovës. Dëshmorët e kombit, civilët, të humburit të gjitha këto do të rregullohen. Sa ka mundësi të bëhet për të humburit në praktikë është problem krejt tjetër, por këto do të rregullohen me ligj.

**Qytetari:** Shtet i kujt do të jetë Kosova?

**Kadri Kryeziu:** Shumë mirë po e kuptoj shqetësimin tuaj, se është dashur të futet në kushtetutë se Kosova është shtet i shqiptarëve. Duhet ta dimë se ne nuk kemi mundur të çlirohemi vet dhe është dashur t'i thërrasim të tjerët që të na ndihmojmë. Ne nuk kemi thënë në kushtetutë se kushtetuta e Kosovës është kushtetutë e ndërkombëtarëve, por kushtetuta e Kosovës është kushtetutë e shtetasve të Kosovës, qytetarëve të Kosovës. Nuk është Kosova shtet multi-etnik, por Kosova është shoqëri multi-etnike. Nuk shkruan në kushtetutë se Kosova është shtet multi-etnik.

**Qytetari:** A do të jenë simbolet para apo pas pavarësisë?

**Kadri Kryeziu:** Është duke punuar komisioni për çështjen e flamurit dhe ju e dini se për këtë ka pasur një konkurs. Sipas kërkesave tona, dihet se çka është simbol për ne, por sipas kërkesave të ndërkombëtarëve, është diçka tjetër që duhet të shpreh realitetin e Kosovës. Edhe ato rregullohen me ligj, sikurse rregullohen në të gjitha vendet tjera.

**Fatmir Fehmiu:** Simbolet dhe kushtetuta nuk e pengojnë pavarësinë e Kosovës.

**Qytetari:** A do të jetë Kushtetutë e fortë Kushtetuta e re e Kosovës?

**Kadri Kryeziu:** Kushtetutë e fortë do të thotë t'i kesh institucionet, presidentin, kryeministrin, qeverinë, mbrojtjen territoriale. Në kushtetutën e fortë qëndron populli.